

LegalNews

Shkurt 2019
February 2019



I. Ligji Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (tani e tutje "Ligji")

Ligji është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më datë 25 Shkurt 2019 dhe shfuqizon Ligjin Nr. 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Ligji hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare.

Ligji është në përputhje me Rregulloren 2016/679 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 27 prill 2016, për mbrojtjen e personave fizik sa i përket përpunimit të të dhënave personale dhe qarkullimit të lirë të këtyre të dhënave.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit, të gjitha të drejtat dhe detyrimet e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale do të barten tek Agjencia për Informim dhe Privatësi (tani e tutje "Agjencia"), një autoritet i pavarur dhe përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji dhe rregulloreve të tjera për mbrojtjen e të dhënave personale dhe qasjes në dokumente publike.

Dispozitat e Ligjit zbatohen për përpunimin e të dhënave personale nga organet publike dhe private, ndërsa nuk zbatohen për përpunimin e të dhënave personale nëse përpunimi kryhet për qëllime krejtësisht personale. Ligji gjen zbatim edhe ndaj të gjitha zyrave diplomatike dhe konsullore, si dhe ndaj të gjitha përfaqësive të tjera zyrtare të Republikës së Kosovës.

I. Law No. 06/L-082 on Protection of Personal Data (hereinafter the "Law")

The Law has been published on the Official Gazette of the Republic of Kosovo on 25 th of February 2019 while it abolishes the previous Law No. 03/L-172 on the Protection of Personal Data. The Law enters into force within fifteen (15) days after its publication in the Official Gazette.

The Law is in compliance with Regulation 2016/679 of the European Parliament and of the Council dated 27 th April 2016, on the protection of natural persons with regard to the processing of personal data and on the free movement of such data.

Upon entry into force of the Law, all the rights and obligations of the National Agency for Personal Data Protection shall be transferred to the Information and Privacy Agency (hereinafter the "Agency"), an independent authority, responsible for the supervision of the implementation of this law for personal data protection and access to public documents.

The provisions of the Law shall apply to the processing of personal data by public and private bodies while it does not apply the processing of personal data if it is done solely for personal purposes. The Law is also applicable for diplomatic and consular offices as well as any other official representative offices of the Republic of Kosovo.

Legjitimiteti për përpunimin e të dhënave

Ligji përcakton kriteret të cilat duhet të përmbushen në mënyrë që të konsiderohet se përpunimi i të dhënave personale është i ligjshëm, duke përfshirë këtu dhe pëlqimin e dhënë nga subjekti i të dhënave për përpunimin e të dhënave personale për qëllime të ndryshme.

Të drejtat e subjektit të të dhënave

Ligji i kushton një rëndësi të veçantë obligimit ligjor të kontrolluesit që të marrë masat e përshtatshme për një informim transparent, komunikim si dhe modalitetet për ushtrimin e të drejtave, të cilat i gëzon subjekti i të dhënave sipas ligjit. Në këtë kontekst, kontrolluesi duhet të marrë masat e përshtatshme për të dhënë çdo informacion në lidhje me përpunimin e të dhënave personale që i nënshtrohen. Kontrolluesi gjithashtu lehtëson ushtrimin e të drejtave të subjektit të të dhënave, përfshirë por duke mos u kufizuar:

- i.** e drejta për qasje nga subjekti i të dhënave;
- ii.** e drejta për të paraqitur një ankesë tek Agjencia;
- iii.** e drejta e korigjimit;
- iv.** e drejta e fshirjes;
- v.** e drejta e kufizimit të përpunimit;
- vi.** e drejta e transferimit të të dhënave;
- vii.** e drejta e kundërshtimit.

Lawfulness of processing data

The Law determines the criteria that needs to be fulfilled in order for the processing of data to be considered lawful, including here the consent from the data subject for the processing of its personal data for different reasons.

Data subject's rights

The Law pays special attention to the legal requirements that the controller needs to undertake for a transparent information, communication and the modalities for the exercise of the rights of the data subjects according to the law. In the context of this, the controller shall undertake all the appropriate measures to provide information regarding the personal data that are being processed. The controller facilitates the exercise of rights from the data subject, including but not limited to:

- i.** the right of access by data subject,
- ii.** the right to lodge a complaint with the Agency;
- iii.** the right of correction;
- iv.** the right of deletion;
- v.** the right to restrict processing;
- vi.** the right data portability;
- vii.** the right to object.

Obligimi për nxjerrjen e akteve te brendshme

Përveç obligimeve të lartcekura, neni 40 i Ligjit parasheh dhe obligimin e kontrolluesit dhe përpunuesit të të dhënave personale që të tregojnë kujdesin e duhur në mbrojtjen e të dhënave personale, kështu duke përshkruar në aktet e tyre të brendshme procedurat dhe masat e vendosura për sigurinë e të dhënave personale.

Kontrolluesit duhet të emërojnë edhe personat përgjegjës për të zbatuar rregullat sipas Ligjit. Duke marrë parasysh karakteristikat specifike të sektorëve të ndryshëm, Agjencia inkurajon dhe hartimin e kodeve të sjelljes që do të ndihmonin në një zbatim të duhur të Ligjit.

Certifikimi

Një risi tjetër ligjore e cila krijon obligim për kontrolluesit dhe përpunuesit e të dhënave personale është që të certifikohen për të kryer punën që lidhet me të dhënat personale.

Kjo certifikatë do të lëshohet nga Agjencia në bazë të kriterëve dhe procedurave të parapara me akt nënligjor. Certifikata mund të ripërtërihet në bazë të kriterëve të përcaktuara në Ligj.

Në rast se personat juridik ose ndërmarrjet posedojnë një certifikatë të lëshuar nga institucionet Evropiane, ajo certifikatë do të njihet si valide, në pajtim me ligjet e Republikës së Kosovës.

Një certifikim i tillë nuk e zvogëlon përgjegjësinë e kontrolluesit apo përpunuesit për të zbatuar kërkesat ligjore të Ligjit si dhe nuk paragjykon detyrat dhe autorizimet e Agjencisë.

Obligation to issue internal acts

Except the abovementioned obligations, article 40 of the Law, obliges the controllers and processors of personal data to show the appropriate care in protection of personal data, thus by drawing up in their internal acts the procedures and the necessary measures established the security of personal data.

By taking into account the specific characteristics of different sectors, the Agency also encourages the drawing up the of codes of conduct, that would help the proper application of this Law. Controllers should nominate the persons in charge for the correct Law implementation.

Certification

Another notable addition of the Law is the obligation of controllers and processors of personal data to be certified in order to perform their work related to personal data.

This certification will be issued by the Agency, based on the criteria and the procedures foreseen in the sub-normative acts. The certificate can be renewed based if the criteria set out in the Law.

In the event that a legal person possesses a certificate issued by the relevant European institutions, that certificate shall be recognize as a valid certificate in accordance with the laws of the Republic of Kosova.

Such certification does not reduce the responsibility of the controller or the processor for compliance with the Law and is without prejudice to the tasks and powers of the Agency.

Deloitte Contacts

Afrore Rudi

Director | Tax & Legal Services
Deloitte Kosova sh.p.k.

Str. Lidhja e Pejes, No. 177
10000 Prishtina, Republic of Kosovo
Mob: +383 (0)49 590 807
E-mail: arudi@deloitteCE.com

Ardian Rexha

Senior Legal Associate| Tax & Legal Services
Deloitte Kosova sh.p.k.

Str. Lidhja e Pejes, No. 177
10000 Prishtina, Republic of Kosovo
Mob: +383 (0)49 780 430
E-mail: arrexha@deloitteCE.com

Vjosa Misini

Senior Legal Associate| Tax & Legal Services
Deloitte Kosova sh.p.k.

Str. Lidhja e Pejes, No. 177
10000 Prishtina, Republic of Kosovo
Mob: +383 (0)49 780 764
E-mail: vmisini@deloitteCE.com

Disclaimer:

This publication contains general information only, and none of Deloitte Touché Tohmatsu Limited, any of its member firms or any of the foregoing's affiliates (collectively the "Deloitte Network") are, by means of this publication, rendering accounting, business, financial, investment, legal, tax, or other professional advice or services.

This publication is not a substitute for such professional advice or services, nor should it be used as a basis for any decision or action that may affect your finances or your business. Before making any decision or taking any action that may affect your finances or your business, you should consult a qualified professional adviser. No entity in the Deloitte Network shall be responsible for any loss whatsoever sustained by any person who relies on this publication.

No entity in the Deloitte Network shall be responsible for any loss whatsoever sustained by any person who relies on this publication.

Deloitte refers to one or more of Deloitte Touché Tohmatsu Limited, a UK private company limited by guarantee, and its network of member firms, each of which is a legally separate and independent entity. Please see www.deloitte.com/al/about for a detailed description of the legal structure of Deloitte Touché Tohmatsu Limited and its member firms.

Deloitte provides audit, tax, consulting, and financial advisory services to public and private clients spanning multiple industries. With a globally connected network of member firms in more than 150 countries, Deloitte brings world-class capabilities and deep local expertise to help clients succeed wherever they operate. Deloitte's approximately 290,000 professionals are committed to becoming the standard of excellence.